



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3, të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenit 37.2 nen paragrafi (c) i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, dhe nenin 5 paragrafi 1.3, neni 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Procedurën e Zëvendësimit të Anëtarit të Kuvendit Komunal, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 24.12.2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z. PAJTIM HODOLLI** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Podujevë, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës- PDK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z. Arbër Blaku.
- II. Obligohet Kryesuesi i Kuvendit Komunal në Podujevë, që ky vendim t'i komunikohet z. Pajtim Hodolli, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 12.12.2019, Nr.1928/2019, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z. Arbër Blaku, nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës në Podujevë, për arsye personale dhe profesionale.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar, se kandidati i radhës në listën e rirenditur është z. Pajtim Hodolli, i cili ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidat i radhës, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 24.12.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka